FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 64	2002	Tetor

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr. 485, datë 16.10.2002	Për dhënie fondi ndihmë disa partive politike të reja…	1797
Vendim i KM nr. 486, datë 16.10.2002	Për miratimin e memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Italiane për zbatimin e programit për importin e energjisë elektrike nga Italia për të zvogëluar dëmet e shkaktuara nga kufizimet e energjisë elektrike në Shqipëri……	1797
Vendim i GjK nr.186, datë 23.9.2002	Me objekt pajtueshmërinë me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë "Statutit të Romës" për Gjykatën Ndërkombëtare Penale…….	1801

V E N D I M
Nr. 485, datë 16.10.2002

PËR DHËNIE FONDI NDIHMË DISA PARTIVE POLITIKE TË REJA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 18 të ligjit nr. 8580, datë 17.2.2000 "Për partitë politike" dhe të nenit 7 të ligjit nr. 8847, datë 19.12.2001 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2002", me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Dhënien e një fondi, si ndihmë financiare, partive politike të reja, si më poshtë vijon:
- Partisë për Mbrojtjen e të Drejtave të Punëtorëve të Shqipërisë, 100 000 (njëqind mijë) lekë.
- Partisë Rruga e Vërtetë Shqiptare, 100 000 (njëqind mijë) lekë.
2. Ky fond të përballohet nga fondet buxhetore të vitit 2002, për partitë politike.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr. 486, datë 16.10.2002

PËR MIRATIMIN E MEMORANDUMIT TË MIRËKUPTIMIT NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS ITALIANE PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT PËR IMPORTIN E ENERGJISË ELEKTRIKE NGA ITALIA PËR TË ZVOGËLUAR DËMET E SHKAKTUARA NGA KUFIZIMET E ENERGJISË ELEKTRIKE NË SHQIPËRI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 dhe 23 të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998 "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Miratimin e memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Italiane për zbatimin e programit për importin e energjisë elektrike nga Italia, për të zvogëluar dëmet e shkaktuara nga kufizimet e energjisë elektrike në Shqipëri.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Memorandum Mirëkuptimi
ndërmjet Qeverisë së Republikës Të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Italiane për Zbatimin e Programit lidhur me importin e energjisë elektrike nga Italia për të zvogëluar dëmet e shkaktuara nga kufizimet e energjisë elektrike në Shqipëri
Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Italisë, më poshtë të referuara si "Palët":
Duke marrë në konsideratë kërkesën e Palës Shqiptare lidhur me importin e energjisë elektrike për të zvogëluar dëmet e shkaktuara nga kufizimet e energjisë;
Duke pasur parasysh që në 4 prill 2002 Komiteti Drejtues i Drejtorisë së Përgjithshme të Bashkëpunimit për Zhvillim (DPBZH) e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës Italiane ka

miratuar dhënien e një kredie të butë prej 30 milion euro për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë, që do të përdoret për blerjen e energjisë elektrike nga prodhuesit italian;

Duke marrë në konsideratë se Pala Italiane ka konfirmuar dhënien e një kredie jashtëzakonisht të butë prej 30 milion euro për përballimin e kësaj nevoje, gjatë takimit të Komisionit Italo-Shqiptar, që u mbajt në Tiranë, në datat 8 dhe 9 prill;

Është rënë dakort si më poshtë:

Neni 1
Kuadri kohor i kredisë

Kredia do të jepet në dy këse, e depozituar në një Llogari Speciale të hapur në Bankën e Shqipërisë, sipas kuadrit kohor të mëposhtëm:

1. Kësti i parë i kredisë për një shumë prej 10 milion euro do të disbursohet për të financuar shpenzimet, duke filluar nga data 4 prill 2002, kur Marrëveshja Financiare (që do të nënshkruhet ndërmjet Mediocredito Centrale dhe Ministrisë së Financës të Republikës së Shqipërisë) do të hyjë në fuqi. Për prokurimin e këtij kësti do të përdoren procedurat e prokurimit të specifikuara në nenin 2 dhe 5 të këtij memorandumi.

2. Kësti i dytë i kredisë për një shumë prej 20 milion euro do të jepet për të financuar shpenzimet pas përfundimit pozotiv të procedurave të garës, sikurse përcaktohet në nenin 2 dhe 5 të këtij memorandumi.

Neni 2
Procedurat e prokurimit

Kredia e butë Italiane mund të përdort nga Huamarrësi vetëm për të financuar importin e energjisë elektrike nga prodhues italianë për të zvogëluar dëmet e shkaktuara nga kufizimet e energjisë në Shqipëri. Energjia elektrike do të blihet në Itali në përputhje me "Udhëzuesin e prokurimit për huatë e dhëna nga BERZH dhe kreditë e IDA-s" dhe ligjit nr. 49, datë 26.2.1987 të Bashkëpunimit për Zhvillimin Italian.

Në veçanti, një shumë deri në 2 milion euro të kredisë së butë mund të prokurohet në përputhje me procedurat e specifikuara në paragrafin 3, 7 (e) ose në paragrafin 3, 5 dhe 3 të udhëzuesit të sipërpërmendur; një shumë e barabartë me 8 milion Euro mund të prokurohet në përputhje me procedurat e specifikaura në paragrafët 3, 5 dhe 3, 6 të udhëzuesit të prokurimeve të Bankës Botërore.

Shuma e mbetur prej 20 milion euro do të prokurohet sipas procedurave të garave, sikurse specifikohet në paragrafin 3.3 dhe 3.4 të udhëzuesit.

Neni 3
Monitorimi

Pala Italiane rezervon të drejtën e monitorimit dhe të vlerësimit të drejtëpërdrejtë të zbatimit të programit. Për këtë qëllim, Pala Shqiptare duhet të vërë në dispozicion të gjitha dokumentet e duhura kur të kërkohen nga Pala Italiane.

Neni 4
Termat dhe kushtet e kredisë së butë

Kredia do të vlerësohet në euro dhe do të ketë kushtet e mëposhtme:
- interesi nominal vjetor:0.20%
- periudha e kthimit:38 vjet
- periudha "falas":17 vjet

Neni 5
Disbursimet dhe procedurat e kontrollit (auditimit)

Të gjitha transaksionet dhe procedurat e prokurimit të kësaj kredie duhet të kontrollohen (auditohen) nga një kompani kontrolluese ndërkombëtare shumë e njohur dhe tepër e kualifikuar, e cila do të kontrollojë dokumentacionin e administrimit dhe procedurat e prokurimit të Programit.

Kontrata ndërmjet Huamarrësit dhe Kompanisë Kontrolluese duhet të dërgohet për miratim (no objection) në Drejtorinë e Përgjithshme të Bashkëpunimit për Zhvillim të Ministrisë së Punëve të Jashtme Italiane (DPBZH-MPJI) para firmosjes së tyre.

Në përputhje me procedurat e pranuara nga Bashkëpunimi Italian për dhënien e kredisë së butë, hapat kryesorë për t'u realizuar para disbursimit të këstit të parë prej 10 milion euro do të jetë si më poshtë:

1. Firmosja e memorandumit në fjalë nga të dy Qeveritë.

2. Autorizimi i Ministrisë Italiane të Thesarit për Mediocredito Centrale (MCC) për të firmosur Marrëveshjen Financiare.

3. Qeveria e Republikës së Shqipërisë ka autorizuar Ministrinë e saj të Financave, si huamarrës i kredisë dhe i ka dhënë MF-së autorizimin dhe fuqinë e nevojshme për të firmosur Marrëveshjen Financiare.

4. Nënshkrimi i Marrëveshjes Financiare nga Mediocredito Centrale dhe Ministria e Financës.

5. Marrja nga ana e Ministrisë së Financave të komunikimit nga Ministri e Punëve të Jashtme Italiane (MPJI) të miratimit (no objection) për zgjedhjen e Kompanisë Kontrolluese.

6. Komunikimi në lidhje me hapjen e Llogarisë Speciale, në të cilën do të kreditohen fondet.

Pas disbursimit të këtij kësti, kompania e kontrollit (auditimit) do t'i japë brenda një muaji MPJI-së dhe MCC-ë një raport me gjithë dokumentacionin përkatës (kontratat, shpenzimet, faturat, dokumentet e garave). Ky raport do t'i referohet shumës totale të disbursuar.

Pas kontrollit të raportit të sipërpërmendur, MCC-ja do t'i komunikojë Huamarrësit shumën totale të transaksioneve të konsideruara si të pranueshme dhe çdo transanskion të konsideruar si të pranueshëm, duke treguar arsyet përkatëse.

Nëse një transaksion do të gjendet jo i pranueshëm, Huamarrësi merr përsipër të kreditojë Llogarinë Speciale me fondin e caktuar për atë transaksion dhe në këtë rast ai duhet të vendosë fondin respektiv për një furnizim të përshtatshëm.

Kësti i dytë 20 milion euro do të kreditohet në Llogarinë Speciale pas miratimit (no objection) nga MCC dhe MPJI, bazuar në raportin e Kompanisë së Kontrollit (auditimit) mbi vlefshmërinë e procedurave respektive (raport i kontrollit të prokurimeve).

Pas diskursimeve të këtij kësti, Kompania e kontrollit (auditimit) do t'i japë MPJI-së dhe MCC-s raporte katërmujore, të shoqëruar me gjithë dokumentacionin përkatës (kontratat, faturat, llogaritë etj.)

Pas kontrollit të raporteve të sipërpërmendura, MCC do t'i komunikojë Huamarrësit shumën totale të transaksioneve të konsideruar si të pranueshme dhe çdo transaksion të konsideruar si jo të pranueshëm, duke treguar dhe arsyet përkatëse.

Nëse një transaksion do të gjendet i papranueshëm, Huamarrësi merr përsipër të kreditojë Llogarinë Speciale me fondin për atë transaksion dhe, në këtë rast, ai duhet të vendosë fondin respektiv për një furnizim të përshtatshëm.

Neni 6
Taksat, tarifat dhe TVSH-ja

Në çfarëdo rrethane, Huaja nuk do të përdoret për të paguar taksat, detyrimet doganore, ose TVSH-në.

Neni 7
Mosmarrëveshjet

Çdo Mosmarrëveshje që mund të lindë ndërmjet Palëve lidhur me interpretimin apo aplikimin e këtij memorandumi mirëkuptimi do të zgjidhet në rrugë diplomatike.

Neni 8
Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e ardhjes së njoftimit të fundit me shkrim, që konfirmon përmbushjen nga Palët të procedurave ligjore të tyre të brendshme.

Në dëshmi të përfaqësuesve të poshtëshënuar të autorizuar nga Qeveritë respektive, kanë firmosur Marrëveshjen aktuale.

Bërë në Tiranë më 19.4.2002 në dy origjinalë në gjuhën angleze, të dyja tekstet janë të barazvlefshme.

Për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë	Për Qeverinë e Republikës Italiane
Ermelinda Meksi	Mario Bova

V E N D I M
Nr.186, datë 23.9.2002

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu	Kryetar	i Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci	Anëtar	i “
Gjergj Sauli	Anëtar	i “
Kristofor Peçi	Anëtar	i “
Kujtim Puto	Anëtar	i “
Petrit Plloçi	Anëtar	i “
Sokol Sadushi	Anëtar	i “
Alfred Karamuço	Anëtar	i “

me sekretare Arbenka Lalica, në datat 28.5.2002 dhe 13.6.2002, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.112 Akti që i përket:

KËRKUES: KRYEMINISTRI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, përfaqësuar nga Suela Ibrahimi, Blerta Kraja e Alban Brati, me autorizim.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. PRESIDENTI I REPUBLIKËS, përfaqësuar nga këshilltari juridik zoti Artur Metani, me autorizim.

2. KUVENDI I SHQIPËRISË, në mungesë.

OBJEKTI:Pajtueshmëria me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i “Statutit të Romës” për Gjykatën Ndërkombëtare Penale.

BAZA LIGJORE:Neni 131 shkronja “b” e Kushtetutës.

Në kërkesën drejtuar Gjykatës Kushtetuese, Kryeministri parashtron se përpara se të paraqesë Traktatin për ratifikim në Kuvendin e Shqipërisë, e sheh të nevojshme shqyrtimin e tij për të vendosur lidhur me pajtueshmërinë me Kushtetutën.

Në seancën gjyqësore, përfaqësuesit e kërkuesit kanë shtruar për diskutim si çështje të veçanta ato që kanë të bëjnë me: transferimin e kompetencave të pushtetit gjyqësor në organizma ndërkombëtarë; mosmarrjen parasysh nga Gjykata Ndërkombëtare Penale e imunitetit nga procedimi penal, që e drejta kombëtare parashikon për një sërë subjektesh; moszbatimi për raste të caktuara nga Gjykata Ndërkombëtare Penale i parimit “ne bis in idem” (mosgjykimi dy herë për të njëjtën akuzë).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Alfred Karamuço, përfaqësuesit e kërkuesit, të subjektit të interesuar dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Gjykata Ndërkombëtare Penale (më poshtë GjNP) e krijuar me Traktatin e Romës të datës 18 korrik 1998 është një organizëm i rëndësishëm ndërkombëtar në ruajtjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut nëpërmjet ndëshkimit penal të akteve barbare kundër qenieve njerëzore si genocidi, krimet kundër njerëzimit, krimet e luftës dhe agresioni.

Gjatë shqyrtimit të statutit të GjNP-së, Gjykata Kushtetuese, konstaton se ai paraqitet si një tërësi dispozitash me karakter penal, procedural penal dhe administrativo-organizativ, duke i paraprirë me një preambul ku shpallen në mënyrë të sintetizuar qëllimi, fizionomia e këtij organi e detyrat e tij themelore në fuqizimin e vazhdueshëm të drejtësisë ndërkombëtare.

Sipas statutit, GJNP-ja ushtron funksionet dhe kompetencat e veta në territorin e shteteve palë. Veprimtaria e saj paraqitet si plotësues i juridiksioneve penale kombëtare në ushtrimin e ndjekjeve penale ndaj personeve fizikë që kryejnë krime të rënda që cenojnë të gjithë komunitetin ndërkombëtar dhe që mund të rrezikojnë paqen, sigurinë dhe mirëqenien e njerëzimit.

Në bazë të nenit 13 të Statutit, Këshilli i Sigurimit i OKB-së, duke vepruar në bazë të Kartës, ka të drejtë t'i paraqesë prokurorit pranë GjNP-së, kërkesë për fillimin e ndjekjeve penale kur ka të dhëna për kryerjen e krimeve në kompetencë të Gjykatës. Po sipas kësaj dispozite, këtë të drejtë e ka edhe shteti përkatës, si dhe vetë prokurori i Gjykatës kryesisht.

Gjykata Kushtetuese konstaton se sipas Statutit, në fazën e hetimit të çështjeve ka kompetenca të gjera kolegji i shqyrtimit paraprak, i cili mbi kërkesën e prokurorit mund të vendosë për masa kufizuese ndaj personit deri në privimin e lirisë, nxjerrjen e urdhrit të arrestit ose urdhrit për paraqitje, mbledhjen, shqyrtimin dhe verifikimin e të dhënave që mund të përbëjnë provë. Kolegji i shqyrtimit paraprak, sipas Statutit, ka të drejtë që nëpërmjet zhvillimit të një seance gjyqësore në prani të prokurorit dhe të personit përkatës, të sigurohet nëse ekzistojnë prova të mjaftueshme që japin arsye serioze për të besuar se personi ka kryer secilin nga krimet që atij i ngarkohet. Në mungesë të provave të tilla, kolegji ose nuk konfirmon akuzat ose urdhëron kryerjen e veprimeve të tjera hetimore.

Në lidhje me gjykimin, Statuti parashikon shqyrtimin e çështjes në kolegjin e shkallës së parë, i cili nëse vërteton fajësinë cakton edhe dënimin që mund të jetë deri në tridhjetë vjet heqje lirie ose burgim i përjetshëm, si dhe dënime plotësuese (neni 77 i Statutit). Vendimi apelohet në Kolegjin e Apelit, i cili ka në kompetencë shfuqizimin ose ndryshimin e vendimit si dhe urdhërimin për rishqyrtim të çështjes në shkallë të parë nga një kolegj tjetër.

Në lidhje me ekzekutimin e vendimeve, Statuti parashikon se ai kryhet në një nga shtetet e listës së shteteve që janë deklaruar të gatshëm të trajtojnë të dënuarit. Ekzekutimi i dënimeve me burgim kontrollohet nga vetë gjykata.

Duke respektuar të drejtat sovrane të çdo shteti për të nënshkruar Statutin, për ta ratifikuar atë, si dhe heqjen dorë prej tij, vetë teksti i Statutit parashikon se procedurave të parashikuara në Statut i nënshtrohen vetëm shtetasit e shteteve që kanë nënshkruar e ratifikuar Statutin; se për secilin shtet, hyrja në fuqi e Statutit bëhet me kalimin e 60 ditëve nga data e depozitimit të instrumenteve të ratifikimit; se çdo shtet ka të drejtë të tërhiqet nga Statuti, por tërheqja kursesi nuk ka fuqi prapavepruese për sa i përket krimeve të ndodhura para tërheqjes (nenet 125, 126 dhe 127).

Në veçanti, Gjykata Kushtetuese konstaton se parimet themelore për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të sanksionuara dhe të garantuara edhe nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, si: prezumimi i pafajsisë; ai i "nullum crimen sine lege" (nuk ka krim pa ligj); "nullum poena sine lege" (nuk ka dënim pa ligj); i ndalimit të fuqisë prapavepruese; i të drejtës së mbrojtjes me një avokat; i pavarësisë së gjyqtarëve; i paraqitjes para gjykatës para arrestimit apo e drejta e apelimit të vendimit, janë të garantuara edhe nga Statuti.

Nga ana tjetër, Statuti parashikon që krimet brenda juridiksionit të gjykatës nuk kushtëzohen nga tërësia e kufizimeve, gjë që ka të bëjë veçanërisht me faktin se krimet që janë në kompetencë të gjykatës, nuk parashkruhen dhe se asnjë parim me vlerë kushtetuese nuk mund të ndalojë

mosparashkrimin e krimeve më të rënda që prekin tërë komunitetin ndërkombëtar.

Një disponim i tillë harmonizohet me qëndrimin e mbajtur nga një sërë dokumentesh ndërkombëtare e sidomos "Konventa mbi mosparashkrimin e krimeve të luftës dhe krimeve kundër njerëzimit", miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së më 26.11.1961; Rezuluta e Asamblesë së Përgjithshme e datës 3.12.1973 "Parimet e bashkëpunimit ndërkombëtar lidhur me zbulimin, arrestimin, ekstradimin dhe ndëshkimin e individëve fajtorë për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit". Këtë qëndrim mban edhe legjislacioni kombëtar shqiptar.

Gjykata Kushtetuese e sheh të domosdoshme të ndalet më hollësisht në disa probleme me rëndësi të posaçme, të cilat u rilevuan edhe nga palët gjatë gjykimit të çështjes, kanë rëndësi për doktrinën dhe kanë shkaktuar debate në parlamentet e gjykatat kushtetuese të një numri vendesh.

I. Juridiksioni i GJNP-së në raport me konceptet kushtetuese të sovranitetit

Në marrëdhëniet e sotme ndërkombëtare ku ndër synimet themelore mbetet integrimi, transferimi në favor të disa organizmave të posaçme në rang botëror apo rajonal i disa kompetencave, të cilat normalisht ushtrohen nga vetë shtetet, tashmë është një realitet. Në këtë drejtim, nuk bëjnë përjashtim edhe kompetencat në fushën gjyqësore.

E konceptuar si një akt bashkëkohor që i hap udhë integrimit, Kushtetuta jonë si në frymë, ashtu edhe në përmbajtje, krijon hapësira për transferim të kompetencave kur kjo bëhet në dobi të paqes, të demokracisë, prosperitetit dhe, gjithmonë, nëpërmjet marrëveshjeve bilaterale apo multilaterale, ku vendi ynë paraqitet si vend sovran me të gjitha atributet që i jep një status i tillë.

Në preambulën e saj, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, pranon si vlerat më të larta të njerëzimit drejtësinë, paqen harmoninë dhe bashkëpunimin ndërmjet kombeve. Në nenin 2 të saj, duke saksionuar sovranitetin si parim themelor të ekzistencës së shtetit, Kushtetuta në funksion të frymës së preambulës dhe të të gjithë përmbajtjes së saj, sanksionon: "Për ruajtjen e paqes dhe të interesave kombëtarë Republika e Shqipërisë mund të marrë pjesë në një sistem sigurimi kolektiv, në bazë të një ligji të miratuar me shumicën e të gjithë anëtarëve të Kuvendit". Kjo dispozitë pasohet në funksion të delegimit të kompetencave shtetërore si formë e delegimit të të drejtave të sovranitetit me nenin 123, i cili në paragrafin e parë sanksionon: "Republika e Shqipërisë, në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare u delegon organizatave ndërkombëtare kompetenca shtetërore për çështje të caktuara". Këto dispozita përmbajnë parime themelore në përshtatje me realitetet e reja, të cilat Shqipëria ka kohë që i njeh "de facto". Ato janë një nga "elementet më të fuqishëm integrues dhe nuk mund të shihen si mohim i sovranitetit të popullit". 1 Për më tepër, në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në rendin e brendshëm juridik, pranohen edhe marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara, të cilat kanë epërsi ndaj ligjeve të vendit (neni 122 i Kushtetutës).

Në këtë rafsh kushtetues, Gjykata Kushtetuese duke shqyrtuar Statutin e GJNP-së, arrin në konkluzionin se veprimtaria dhe funksionet e saj nuk cenojnë dispozitat tona kushtetuese përsa i përket ushtrimit të sovranitetit. Mundësia për të kontraktuar angazhime kushtetuese ndërkombëtare në një fushë të tillë të rëndësishme si ajo e drejtësisë penale, përbën një atribut të ushtrimit të sovranitetit të shtetit.

Sipas Statutit, funksioni i GJNP-së është komplementar ndaj juridiksionit penal vendas, ç'ka do të thotë se ajo, (GJNP), vihet në lëvizje për gjykimin e krimeve të caktuara kur shteti palë në Traktat vërtetohet se nuk paraqet vullnet për t'i gjykuar ato, ose kur shteti e bën atë formalisht.

Funksioni komplementar i GJNP-së ndaj juridiksionit gjyqësor penal vendas, apo edhe vendosja e dispozitave të Statutit në rendin e brendshëm juridik, nuk vijnë ndesh me Kushtetutën e konkretisht, me nenin 135 ku përcaktohen rigorozisht organet e pushtetit gjyqësor në Shqipëri të krijuara me ligj, dhe ku përjashtohet në mënyrë kategorike krijimi i gjykatave të jashtëzakonshme. Nga vetë përmbajtja e Statutit, del qartë se këtu nuk bëhet fjalë për një organizëm kombëtar e as për një gjykatë të jashtëzakonshme. GJNP-ja nga natyra e saj është një institucion gjyqësor legal dhe ndërkombëtar, i krijuar me vullnet të lirë të shteteve sovrane palë në Statut, dispozitat e të cilit bazohen mbi parimin e respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut.

Duke iu referuar raporteve të sovranitetit me pranimin e juridiksionit të GJNP-së, Gjykata Kushtetuese çmon se ka rëndësi të posaçme problemi i vëllimit të kompetencave të transferuara. Më

[1] Raport "Për Projektkushtetutën e Republikës së Shqipërisë".

konkretisht, problemi shtrohet se deri ku mund të shtrihet ky transferim i kompetencave (i lejuar posaçërisht nga neni 123 i Kushtetutës).

Përgjigja e kësaj pyetje del në radhë të parë nga vetë fryma e Kushtetutës, por më të konkretizuar e gjejmë në jurisprudencën kushtetuese ndërkombëtare sipas së cilës, "…transferimi i të drejtave të sovranitetit i ka kufijtë atje ku identiteti kushtetues i shtetit fillon të vihet në diskutim…" 1, ose se "…kufiri i transferimit të të drejtave qëndron deri atje ku ky transferim çon në shkeljen e kushteve themelore për ushtrimin e sovranitetit kombëtar"2.

Zgjidhja e këtij problemi ka rëndësi të përgjithshme për vendin tonë, i cili po bën përpjekje të vazhdueshme e konsekuente për t'u integruar në strukturat ndërkombëtare e veçanërisht ato euroatlantike.

Nga sa u parashtrua, Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë nuk e sheh si tejkalim të këtyre kufijve transferimin e disa kompetencave të pushtetit gjyqësor në një fushë të caktuar me interes ndërkombëtar siç është ajo e përndjekjes së autorëve të krimeve të genocidit, krimeve kundër njerëzimit, krimet e luftës e agresionit.

Statuti i GJNP-së përmban edhe dispozita të tjera konkrete, përmbajtja e të cilave detyrimisht duhet analizuar e ballafaquar me dispozitat kushtetuese. Kjo, për shkak se në këto raste, pajtueshmëria e tyre nuk gjen plotësisht zgjidhje me atë çka u shtjellua për transferimin e kompetencave. Të tilla dispozita janë ato për mosnjohjen e imunitetit në procesin penal si dhe shmangia në raste të caktuara nga parimi "ne bis in idem".

II. Imuniteti në procesin penal

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në një sërë dispozitash ka parashikuar imunitetin nga procedimi penal si pjesë integrale të statusit juridik për një numër subjektesh, duke filluar nga kryetari i shtetit, deputetët, anëtarët e qeverisë, etj. Në këtë drejtim, Gjykata Kushtetuese konstaton se statuti i GJNP-së nuk e njeh këtë status juridik të posaçëm të subjekteve të caktuara.

Posaçërisht, neni 27 i Statutit, duke folur për irelevancën e pozitës zyrtare parashikon: "Ky Statut do të zbatohet njësoj ndaj të gjithë personave, pa asnjë dallim të bazuar në pozitën zyrtare. Në veçanti, pozita zyrtare si shef i shtetit, i qeverisë apo parlamentit, përfaqësues i zgjedhur i qeverisë apo zyrtar i qeverisë, në asnjë rast nuk do të përjashtojë një person nga përgjegjësia penale sipas këtij Statuti, as që ai, nga vetja të krijojë bazë për reduktimin e dënimit".

Imunitetet apo rregullat speciale procedurale që mund t'i jenë bashkëngjitur pozitës zyrtare të personit, sipas të drejtës kombëtare apo asaj ndërkombëtare, nuk duhet të pengojnë Gjykatën nga ushtrimi i juridiksionit të saj mbi një person të tillë.

Duke analizuar këto dispozita, Gykata Kushtetuese konstaton se ato nuk vijnë ndesh me atë ç'ka përcakton Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.

Në radhë të parë, Gjykata Kushtetuese pranon se rregullimet e brendshme për imunitetin nuk pengojnë transferimin e juridiksionit tek GJNP-ja. Kjo, për shkak se imuniteti i shërben mbrojtjes përballë gjyqësorit vendas dhe se ai rrjedh nga parimi i ndarjes e balancimit të pushteteve të garantuara nga Kushtetuta.

Statuti nuk vjen në kundërshtim, as anashkalon dispozitat kushtetuese lidhur me imunitetin e kryetarit të shtetit e të një sërë subjektesh të tjera për faktin se imuniteti i këtyre subjekteve i përket juridiksionit kombëtar. Kjo nuk mund të ndalojë një organizëm ndërkombëtar si GJNP-ja në ushtrimin e juridiksionit të saj mbi persona të kësaj kategorie, të cilët kanë kryer krimet e parashikuara nga Statuti i Romës.

Me këtë rast, Gjykata Kushtetuese e sheh të nevojshme të shprehet se përderisa në bazë të Kushtetutës rregullat e gjithëpranuara të së drejtës ndërkombëtare janë pjesë e së drejtës së brendshme, atëherë dhe mungesa e imunitetit në proceset penale ndërkombëtare për krime të caktuara me rrezikshmëri të lartë, bëhet pjesë e sistemit juridik shqiptar. Nga ana e saj, jurisprudenca ndërkombëtare ka përpunuar një sërë zakonesh të qëndrueshme nisur nga synimi kryesor, që autorëve të këtyre veprave penale, t'u hiqet mundësia që të mbrohen për to duke i konsideruar si akte të kryera në ushtrimin e pushtetit (acta iure imperii).

Kapërcimi i imunitetit të kryetarit të shtetit apo qeverisë është bërë një praktikë e njohur në të

[1] Vendim i datës 12 tetor 1993 i Gjykatës Kushtetuese Federale Gjermane mbi Traktatin e Mastrihtit

[2] Vendim i Këshillit Kushtetues Francez, viti 1985

drejtën ndërkombëtare publike, duke u bërë një referencë e fuqishme për gjykatat në përforcim të idesë se imuniteti ndaj ndjekjes penale për kryetarin e shtetit, të qeverisë etj., nuk mund të aplikohet për krimet me rëndësi ndërkombëtare, si genocidi, krimet kundër njerëzimit, krimet e luftës, agresioni.1 Këto ide gjenden të pranuara në Traktatin e Versajës, në Kartën e Gjykatës Ndërkombëtare të Nurembergut, në Konventën për Parandalimin e Genocidit, në Statusin e GJNP-së për ish Jugosllavinë, Ruandën etj.

III. Statuti dhe parimi kushtetues "ne bis in idem" (mosdënimi dy herë për të njëjtin krim)

Në radhën e parimeve mbi bazën e të cilave udhëhiqet veprimtaria e GJNP-së, është edhe parimi "ne bis in idem", i cili gjen pasqyrim në nenin 20 të Statutit. Në këtë dispozitë dallohen dy aspekte: ai i zbatimit të këtij parimi në gjykimet brendapërbrenda gjykatës dhe në atë që lidhet me gjykimet e gjykatave të tjera.

Në aspektin e parë, Statuti ndalon GJNP-në të rigjykojë një person për një vepër për të cilën ai është gjykuar apo liruar më parë po nga GJNP-ja (pika 1). Në pikën 2 parashikohet ndalimi për gjykatat e tjera që të gjykojnë personin për veprën për të cilën ai është gjykuar apo liruar nga GJNP-ja.

Në aspektin e dytë, statuti ka pranuar rregullin sipas të cilit GJNP-ja bëhet kompetente të gjykojë personin për vepra për të cilat ai është hetuar apo gjykuar nga juridiksionet kombëtare vetëm kur kjo bëhet e nevojshme:

(a) për mbrojtjen e personit nga përgjegjësia penale;

(b) kur gjykimi nuk është zhvilluar në mënyrë të pavarur dhe të paanshëm, në pajtim me normat e procesit të rregullt të njohura nga e drejta ndërkombëtare dhe janë zhvilluar në mënyrën që personi t'i shpëtojë përgjegjësisë penale ose t'i lehtësohet kjo përgjegjësi.

Ndërkohë, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në nenin 34, në të Drejtat dhe Liritë Themelore pranon se: "Askush nuk mund të dënohet më shumë se një herë për të njëjtën vepër penale dhe as të gjykohet sërisht, me përjashtim të rasteve kur është vendosur rigjykimi i çështjes nga një gjykatë më e lartë sipas mënyrës së parashikuar me ligj".

Ky parim gjen shprehjen e vet edhe në një sërë dokumentesh ndërkombëtare e posaçërisht, në Paktin Ndërkombëtar lidhur me të drejtat civile dhe politike (neni 14 pika 7) miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së më 16 dhjetor 1966.

Duke ballafaquar dispozatat e Statutit me ato të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese arrin në konkluzionin se ato nuk vijnë ndesh me njëra-tjetrën. Shqyrtimi i çështjeve nga GJNP-ja, sipas nenit 20, pikës 3, shkronjat "e", "a" dhe "b", në vetvete ka natyrën e një rishqyrtimi, të cilin sipas dispozitës së sipërcituar të Kushtetutës e ka në kompetencë gjykata më e lartë. Me këtë shprehje, Kushtetuta nuk ka parasysh institucionin e Gjykatës së Lartë, por gjykatën më të lartë sipas një renditjeje të caktuar. Kështu, GjNP-ja paraqitet në fakt si gjykata më e lartë (lidhur me gjykimin e krimeve të caktuara).

Në bazë të preambulës së Statutit, GJNP-ja paraqitet si gjykatë plotësuese e juridiksionit kombëtar. Në rastet kur vërtetohet se autoriteti gjyqësor i brendshëm nuk ka zhvilluar një procedim real e ky proces konsiderohet nul, i paqenë, vihet në lëvizje GJNP-ja si një gjykatë më e lartë.

Gjykata Kushtetuese vlerëson se një rregullim i tillë juridik në Statut i shërben qëllimit për të cilin është ngritur GJNP-ja. Nëse lufta kundër krimeve të rënda duhet të jetë efektive, në radhë të parë ajo duhet të ndihmojë në mënjanimin e shfaqjeve të varësisë së institucioneve gjyqësore kombëtare ndaj subjekteve të inkriminuar, të cilët eventualisht, mund të veprojnë me cilësinë e kryetarit të shtetit, të qeverisë, autoritetit të Parlamentit etj.

Si përfundim, Gjykata Kushtetuese, duke shqyrtuar dispozitat e Statutit, duke e marrë atë në tërësi dhe duke e ballafaquar me frymën dhe përmbajtjen e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, konstaton se Statuti nuk vjen në kundërshtim me Kushtetutën. Për rrjedhojë, nuk ekzistojnë pengesa kushtetuese për ratifikimin e tij.

Gjykata Kushtetuese është e bindur se ratifikimi i Statutit të GJNP-së përbën një kontribut të rëndësishëm të vendit tonë në krijimin e mundësive dhe hapësirave në luftën kundër terrorizmit në çdo formë që paraqitet ai.

---

[1] Dhoma e Lartë e Mbretësisë së bashkuar në çështjen Pinoçet, për mungesën e imunitetit është shprehur: "…një përfundim i kundërt do të ishte një shmangie nga e drejta ndërkombëtare".

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 131 shkronja “b” të Kushtetutës, si dhe të nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

V E N D O S I:

- Statuti i Gjykatës Ndërkombëtare Penale, krijuar me Traktatin e Romës, nënshkruar nga Republika e Shqipërisë në datën 18 korrik 1998, është në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
Rr.Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë **Qendrës së Publikimeve Zyrtare** mund të gjeni:
- Kodin Penal (të azhurnuar);
- Kodin e Procedurës Penale (të azhurnuar);
- Kodin Civil (të azhurnuar);
- Përmbledhjen e legjislacionit në fushën e transporteve (Kodin Rrugor dhe ligjin për transportet, e azhurnuar);
- Kodin Zgjedhor (të azhurnuar);
- Kodin Doganor (Dispozitat zbatuese të Kodit Doganor).

Kodi Penal	**Kodi i Procedurës Penale**	**Kodi i Procedurës Civile**	**Kodi Rrugor**
Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare	*Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare*	*Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare*	*Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare*
Mars, 2002	Shtator, 2002	Korrik, 2002	Qershor,2002

U dorëzua për shtyp më 21. 10. 2002
Doli nga shtypi më 21. 10. 2002

Tirazhi: 4250 copë Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2002

Çmimi: 100 lekë